VENDIM
Nr. 167, datë 18.3.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, VORË, KAMZË DHE RROGOZHINË

(ndryshuar me vendimin nr. 777, datë 12.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 509 744 532 (një miliard e pesëqind e nëntë milionë e shtatëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara në bashkitë Durrës, Vorë, Kamzë dhe Rrogozhinë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës, në masën 462 554 300 (katërqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind) lekë;

b) Bashkisë Vorë, në masën 369 471 748 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) lekë;

c) Bashkisë Kamzë, në masën 88 600 000 (tetëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë;

ç) Bashkisë Rrogozhinë, në masën 589 118 484 (pesëqind e tetëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga bashkitë Durrës, Vorë, Kamzë dhe Rrogozhinë, në masën 905 846 718 (nëntëqind e pesë milionë e tetëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 277 532 580 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë;

b) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 221 683 048 (dyqind e njëzet e një milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyzet e tetë) lekë;

c) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 53 160 000 (pesëdhjetë e tre milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë;

ç) Bashkisë Rrogozhinë i transferohet fondi, në masën 353 471 090 (treqind e pesëdhjetë e tre milionë e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëdhjetë) lekë.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 183 228 700 (njëqind e tetëdhjetë e tre milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Vorë dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 147 788 700 (njëqind e dyzet e shtatë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 35 440 000 (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Efekti financiar, për vitin 2022, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet bashkive Durrës, Vorë, Kamzë dhe Rrogozhinë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës, Vorë, Kamzë dhe Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama